

VENDIM
Nr. 214, datë 9.4.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE
DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 3, e 75, të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, për vitin 2014, lejohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve për mobilim zyrash. Në procedurat e prokurimit, përfshihen: lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama